



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
KRYETARI

Nr. 2507 / Prot.
2

Patos, më 10/10 /2023

VENDIM

Nr. 322 datë 10/10 /2023

PËR MIRATIMIN E PLANIT STRATEGJIK DHE VJETOR 2024 - 2026

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 8 dhe 9 të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" dhe të pikës ç të nenit 12 të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", vendosa:

1. Të miratoj Planin Strategjik dhe Vjetor të Auditimit të Brendshëm për periudhën 2024 – 2026, së bashku me pasqyrat e auditimit sipas lidhjes 1, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Faton Duro



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 507/Prot.
2

Patos, më 10/10/2023

PLANI STRATEGJIK 2024-2026

DHE

PLANI VJETOR 2024

PËR

AUDITIMINE BRENDSHËM



Plani strategjik 2024-2026 për Auditimin e Brendshëm në Bashkinë Patos përcakton drejtimit në të cilat do të zhvillohet veprimtaria e njësisë së auditimit të brendshëm gjatë periudhës për të cilën po hartohet ky plan, kohën dhe burimet e nevojshme për realizimin e objektivave. Ky plan është hartuar mbi bazën e një rishikimi të përgjithshëm dhe analizës së riskut të fushave/sistemeve që i nënshtrohen auditimit.

I. QËLLIMI I PLANIT STRATEGJIK DHE MISIONI I NJAB

I.1 Qëllimi i Planit Strategjik

Qëllimi i hartimi të planit strategjik dhe planit vjetor të NJAB – së, Bashkia Patos është të përcaktojë prioritetet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm në përputhje me qëllimet dhe objektivat e bashkisë Patos. Hartimi i planit strategjik dhe vjetor synon që nëpërmjet veprimtarisë të sektorit të auditimit të brendshëm për periudhën e planifikuar të realizojë forcimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, përmirësimin e qeverisjes dhe maksimizimin e kapaciteteve të stafit të audituesve.

Vlerësimi i nevojave të auditimit do të rishikohet cdo vit, në kohën kur do të hartohet plani vjetor i auditimit për vitin e ardhshëm, duke u siguruar që janë përfshirë të gjitha veprimtaritë e reja dhe ndryshimet e tjera të programeve.

Frekuenca e auditimit është përcaktuar duke u bazuar në shkallën e riskut që shoqëron funksionin e auditimit gjatë implementimit të tij.

I.2 Misioni i NJAB

Misioni i njësisë së Auditimit të Brendshëm në bashkinë Patos është të përmirësojë veprimtarinë e institucionit duke vlerësuar dhe ofruar siguri të arsyeshme për menaxhimin e burimeve, përmirësimin e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të riskut si dhe të ofrojë këshillim për menaxhimin i projektuar për të shtuar vlerë.

Për realizimin e misionit, specialistët e njësisë së auditimit mbështeten në:

1. Parimet kryesore të auditimit
 - a) I ligjshmërisë
 - b) Paanësisë
 - c) Pavarësisë
 - d) Integritetit
 - e) Konfidencialitetit
 - f) Profesionalizmit
2. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm
3. Legjislacionin në fuqi
4. Karta e Auditimit të Brendshëm dhe Kodi Etik



Adresa: Lagjja "Nafëtari", Rruga "Unaza", Patos

II. ORGANIZIMI I NJAB DHE KUADRI LIGJOR

II.1 Organizimi i NJAB

Njësia e Auditimit të Brendshëm në bashkinë Patos është organizuar në nivel sektori, e përbërë nga përgjegjësi i njësisë dhe dy specialistë. Në zbatim të ligjit nr.114/2014 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik” njësia e auditimit të brendshëm raporton direkt dhe është në varësi të Kryetarit të Bashkisë.

II.2 Kuadri Ligjor

Funksionimi i Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Patos bazohet në;

a. *Kuadri kombëtar i Auditimit të Brendshëm*

- ✓ Ligji nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar.
- ✓ Urdhëri i Ministrisë së Financave nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik”.
- ✓ Urdhëri i Ministrisë së Financave nr. 86, datë 10.12.2015 “Për miratimin e Kodit të Etikës për audituesit e brendshëm në sektorin publik”.

b. *Kuadri ndërkombëtar*

- ✓ Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm.
- ✓ Praktikant Profesionale të Publikuara nga IIA.

c. *Kuadri ligjor për njësitë e qeverisjes vendore*

- ✓ Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015. “Për vetëqeverisjen vendore”;
- ✓ Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- ✓ Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”; Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”;
- ✓ VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- ✓ Etj.,



III. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Objektivi strategjik i funksionimit të auditimit të brendshëm është të nxisë politikat e qeverisjes së mirë, përmirësimin dhe forcimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Objektivat e njësisë së auditimit të brendshëm në bashkinë Patos për periudhën 2024-2026 janë:

1. Dhënia e një sigurie të arsyeshme tek Titullari mbi saktësinë dhe besueshmërinë e raporteve financiare dhe raporteve të performancës, të pregatitura nga struktura e menaxhimit.
2. Dhënie e sigurisë objektive që risqet janë identifikuar, vlerësohen dhe menaxhohen nga strukturat përgjegjëse.
3. Shqyrtimi, vlerësimi dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e kontrollit të brendshëm dhe realizimin e transaksioneve.
4. Të ofrojmë programe të konsulencës për menaxhimin për fusha specifike.
5. Përdorimi i metodologjive bashkëkohore të auditimit në përputhje me standardet e auditimit.
6. Përmirësimi i kapaciteteve audituese.
7. Njohja e stafit me rolin dhe funksionin e auditimit të brendshëm si mbështetje për menaxhimin për realizimin me kujdes të objektivave të tij duke rekomanduar praktikat më të mira për krijimin e rregullave dhe procedurave specifike për çdo proces pune.

IV. IDENTIFIKIMI I SUBJEKTEVE

Duke u bazuar në organizimin e bashkisë Patos për periudhën 2024-2026, auditimi në bashkinë Patos dhe njësitë vartëse do të fokusohet në mbulimin me auditim të të gjitha subjekteve të varësisë. Planifikimi strategjik i ndarë sipas viteve është bërë duke u bazuar në nivelin e riskut që paraqesin subjektet që do të auditohen.

Nr.	2024	2025	2026
1	Drejtoria e Integritimit European, Arsimit, Kulturës dhe Sporteve	Drejtoria e të ardhurave vendore	Drejtoria e Financës dhe Shërbimit Social
2	Drejtoria e Financës dhe Shërbimit Social	Drejtoria e Financës dhe Shërbimit Social	Drejtoria e të ardhurave vendore
3	Drejtoria e të Ardhurave Vendore	Sektori i prokurimeve publike	Sektori i prokurimeve publike
4	Sektori i prokurimeve publike	Sektori i Planifikimit Urban	Drejtoria e Planifikimit Urban, projekteve, shërbimeve dhe



5	Drejtoria e Planifikimit Urban, projekteve, shërbimeve dhe emergjencave civile	Inspektoriati vendor i mbrojtjes së territorit	emergjencave civile Njësia administrative Ruzhdie
6	Agjencia e Shërbimeve Publike	Policia Bashkiake	Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Legjislacionit dhe Informimit publik
7	Kopshti nr.1	Njësia Administrative Zharrëz	Agjencia e shërbimeve publike
8	Qendra kulturore e fëmijëve	Spektori i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit	Kopshti nr.1
9	Drejtoria e zhvillimit bujqësor, rural, pyjor, mjedisit dhe kontrollit të ushqimeve	Agjencia e shërbimeve publike	Spektori i Integritit European
9	Spektori i zyrës me një ndalesë	Zbatimi i rekomandimeve të auditimit të brendshëm	
10	Zbatimi i rekomandimeve të auditimit të brendshëm	Klubi shumësportësh Albpetrol	
11		Spektori Juridik	

V. IDENTIFIKIMI I FUSHAVE/SISTEMEVE PRIORITARE

Për identifikimin e subjekteve që do të auditohen janë marr parasysh objektivat e subjektit, fondet buxhetore që kanë në përdorim subjektet e audituara, fushat e veprimtarisë së këtyre subjekteve, riskun që mbulojnë dhe vlerësimin nga auditimet e kaluara.

Për subjektet e audituara që do t'i nënshtrohen auditimit janë planifikuar auditime përputhshmërie, financiare, performance dhe auditime të kombinuara në fushat e veprimtarive dhe aktiviteteve për cdo strukturë në përputhje me funksionet dhe detyrat e përcaktuara në rregulloren e brendshme dhe objektivat e vendosura. Sistemet e identifikuara janë:

1. Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit
2. Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar duke përfshirë detyrimet e prapmbetura
3. Sistemi i taksave dhe tarifave vendore
4. Sistemi i prokurimeve
5. Sistemi i pagesave
6. Sistemi i menaxhimit të riskut
7. Sistemi i burimeve njerëzore
8. Sistemi i investimeve
9. Sistemi i kontrollit të brendshëm



VI. IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I RISQEVE

Për identifikimin e riqeve njësia e auditimit është bazuar në:

1. Regjistrin e riskut të bashkisë Patos
2. Raportet e mëparshme të auditimit nga KI SH dhe NJAB
3. Planin i Integritetit të bashkisë Patos

Bazuar në këto raporte sisteme me risk të lartë janë vlerësuar:

1. Sistemi i prokurimeve
2. Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar
3. Sistemi i menaxhimit të riskut
4. Sistemi i kontrollit të brendshëm
5. Investimet

Me risk të mesëm janë vlerësuar:

1. Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit
2. Sistemi i taksave dhe tarifave vendore
3. Sistemi i pagesave
4. Sistemi i burimeve njerëzore

VII. KUFIZIMET E AUDITIMIT

Kufizimet që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave të auditimit të brendshëm janë:

- Sektori i AB mund të ketë kufizime të ndryshme për shkak të të ndryshimeve të planit sipas kërkesave të menaxhimit jashtë planit të miratuar
- Mosndjekja dhe zbatimi nga menaxhimi i rekomandimeve të dhëna nga auditimi
- Ndryshimet në stafin e NJAB dhe mosplotësimi i strukturës së NJAB

VIII. PRIORITETET PËR VITET (1+2)

Prioritetet e njësisë së auditimit të brendshëm për 3 vitet e ardhshme në lidhje me përmirësimin e punës audituese do të jetë:

- Ngritja dhe zhvillimi profesional i audituesve
- Ofrim i sigurisë i tillë që veprimtaria e auditimit të konsiderohet nga strukturat e larta drejtuese si shtim vlere.
- Ofrim i programeve të këshillimit
- Njohje e rolit dhe funksionit të NJAB nga stafi i bashkisë
- Kryerja e misioneve të auditimeve të brendshme në përputhje me ligjin, manualin dhe standardet e AB
- Bashkëpunim me subjektet e audituara për hartimin e rekomandimeve cilësore dhe ndjekjen e zbatimit të tyre



PLANI VJETOR 2024

1. Zhvillimet aktuale të Njesisë së Auditimit të Brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm në bashkinë Patos e ushtron veprimtarinë e vet në bazë të ligjit nr. 114/ 2015 " Për auditimin e brendshëm në sektorin publik i ndryshuar".

Struktura e NJAB në bashkinë Patos për vitin 2023 është miratuar me VKB nr. 92, datë 19.12.2022 në nivel sektori e përbërë nga 1 përgjegjës dhe 2 specialistë.

Spektori i AB për vitin 2023 ka planifikuar 12 auditime nga të cilat janë realizuar 9 auditime sipas planit të miratuar. Subjektet e audituara janë:

1. Njësia Administrative Zharrëz
2. Njësia Administrative Ruzhdie
3. Drejtoria e të Ardhurave vendore
4. Drejtoria e Financës
5. Sektori i Prokurimit Publik
6. Drejtoria e Arsimit, Kulturës dhe Sporteve
7. M.Z.SH
8. Drejtoria e Planifikimit Urban (me ristrukturimin e bashkisë sipas VKB nr. 37, datë 30.06.2023 është Sektori i Planifikimit Urban)
9. Inspektoriat i ndërtimor

Aktualisht NJAB është duke audituar Drejtorinë e Burimeve Njerëzore në përputhje me planin vjetor. Gjithashtu NJAB ka kryer dhe 2 auditime me urdhër të Titullarit jashtë planit vjetor:

1. Auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël dhe zbatimin e PSV-ve për harxhimin e karburantit sipas urdhërit nr. 27, datë 06.02.2023.
2. Auditimi i dosjeve të përfutësve të banesave sociale sipas urdhërit nr. 124, datë 21.07.2023.

Për realizimin e 2 auditimeve të mësipërme nuk janë realizuar shmangie nga plani vjetor.

Gjatë vitit 2023 NJAB u auditua edhe nga KLSH ku u la një rekomandim për kryerjen e vlerësimit të brendshëm të cilësisë. NJAB e zbatoi rekomandimin duke hartuar programin e sigurimit të cilësisë me nr. 2033 prot., datë 28.07.2023 dhe duke kryer vlerësimin e brendshëm të cilësisë për cdo subjekt të audituar sipas programit.

2. Prioritetet e auditimit të brendshëm për vitin 2024

Për vitin 2024 prioritetet kryesore do të jenë:

- Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm
- Kryerja e auditimeve në sistemet kryesore dhe me risk të lartë
- Rritja e cilësisë së punës audituese për dhënien e rezultateve që shtojnë vlerë
- Zhvillimi profesional i audituesve
- Vlerësimi i statusit të zbatimit të rekomandimeve
- Vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve dhe

Adresa: Lagjja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos



sigurimet shoqërore si dhe shërbimet e tjera si paisje kompjuterike, kancelari etj.

6. Planifikimi i burimeve për vitin 2024

Planifikimi i burimeve për vitin 2024 është përgatitur mbi bazën e burimeve aktuale në dispozicion. Përlllogaritja e burimeve është kryer sipas pasqyrës nr. 5. Numri i ditëve të planifikuara është 206 ditë/ person.

7. Planifikimi i nevojave të stafit për trajnim

Një ndër objektivat kryesor të sektorit të AB për vitin 2024 është edhe zhvillimi profesional i audituesve të brendshëm. Për këtë qëllim në pasqyrën nr. 4 janë përcaktuar nevojat dhe janë identifikuar temat për trajnim. Meqenëse misioni i angazhimit kryhet në grup a është përcaktuar e njëjta periudhë trajnimi për audituesit si dhe mundësia e çertifikimit të specialistëve.

8. Sigurimi i brendshëm i cilësisë

Programi i sigurimit të cilësisë është projektuar për të mundësuar vlerësimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm si dhe për të vlerësuar nëse audituesit e brendshëm e zbatojnë Kodin e Etikës dhe standardet. Gjatë vitit 2024 sigurimi i cilësisë së auditimit të brendshëm do të kryhet sipas programit të hartuar një njësia dhe të miratuar me nr. 2033 prot., datë 28.07.2023.

Bashkëngjitur janë pasqyrat të cilat pasqyrojnë më në detaje aktivitetin e punës së Sektorit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2024, si dhe planifikimi strategjik për vitet 2024-2026.

- **Pasqyra nr. 1** Vlerësimi i nivelit të risqeve për të gjitha subjektet që do të auditohen nga NJAB;
- **Pasqyra nr. 2** Plani strategjik i subjekteve për t'u audituar për vitet (1+2);
- **Pasqyra nr. 3** Plani i angazhimeve të NJAB për vitin;
- **Pasqyra nr. 4** Plani i nevojave për trajnim të NJAB për vitin;
- **Pasqyra nr. 5** Planifikimi i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB për vitin.

Nëse është e nevojshme gjatë vitit mund të bëhen ndryshime në planin fillestar duke marrë miratimin e Titullarit.

Përgjegjëse e Sektorit të Auditimit të Brendshëm

Ernesta Hamiti



NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM BASHKIA PATOS

Pasqyra I

Vlerësimi i nivelit të riskut për të gjitha subjektet që duhet të auditohen nga NJAB

Nr.	Subjekte për tu audituar	Fusha për tu audituar	Vlerësim i përgjithshëm i riskut	
			I lartë	I mesëm
1	Bashkia	1- Drejtoria e Integrimit European, Arsimit, Kulturës dhe Sporteve Përfitimimi dhe ndjekja e projekteve të fituara Përfitimimi i fondeve IPA Klubi Sportiv Albpetrol Cerdhe	X	X
		2- Drejtoria e Financës dhe Shërbimit Social Sistemi i pagesave Detyrimet e prapambetura Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar Sistemi i kontrollit të brendshëm Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit Sistemi i pagave dhe realizimit të	X	X



	shpenzimeve			
	3- Drejtoria e të Ardhurave Vendore	X		
	Sistemi i taksave dhe tarifave vendore		X	
	Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënie me qera të aseteve dhe arkëtimi i detyrimeve	X		
	Debitorët	X		
	4- Sektori i Prokurimeve	X		
	Sistemi i prokurimeve	X		
	Blerje me vlerë të vogël	X		
	5- Drejtoria e Planifikimit Urban, projekteve, shërbimeve dhe emergjencave civile	X		
	Sistemi i lejeve	X		
	Menaxhimi i shërbimeve publike	X		
	Menaxhim i aseteve	X		
	Monitorimi dhe zbatimi i investimeve	X		
	Politikat e strehimit	X		
	6- Drejtoria e Zhvillimit Bujqësor, rural, pyjor, mjedisit dhe kontrollit të		X	



	ushqimeve				
	Ndjekja dhe arkëtimi I tokave të dhëna me qera				X
	Politikat e ndjekura dhe masat e marra për mbrojtjen e mjedisit				X
	7- Drejtoria e Burimeve njerëzore, legjisllacionit dhe informimit publik				X
	Rekrutimi dhe protokoll arkiva				X
	Shërbimet në zyrën me një ndalesë				X
	Sektori juridik				X
	8- Inspektoriati vendor i mbrojtjes së territorit		X		
	Dhënia e vendimeve administrative dhe zbatimi i afateve		X		
	Debitorët				X
	9- Policia Bashkiake				X
	10- Kopshti nr.1				
	Sistemi i pagesave				X
	11-QKF				X
	1. Sistemi i prokurimeve		X		
	2. Sistemi i Pagesave		X		
	3. Sistem i kontabilitetit dhe raportimit financiar		X		
	Agjencia e Shërbimeve Publike				



3	Njësia Administrative Zharrës	1- Sistemi i taksave dhe tarifave vendore 2- Sistem i kontrollit të brendshëm	X X
4	Njësia Administrative Ruzhdie	1. Sistemi i taksave dhe tarifave vendore	X
5	M.Z.SH	1. Sistem i menaxhimit të karburantit 2. Sistem i pagesave	X X

Drejtuuese e NJAB
Ernesta Hamiti




NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM BASHKIA PATOS

Pasqyra 2

Plani strategjik i subjekteve për tua audituar për vitet 2024-2026

SUBJEKTE TË SYNUARA PËR TU AUDITUAR SIPAS VITEVE					
Nr.	2024	2025	2026		
1	Drejtoria e Integritimit European, Arsimit, Kulturës dhe Sporteve	Drejtoria e të ardhurave vendore	Drejtoria e Financës dhe Shërbimit Social	I lartë	I lartë
2	Drejtoria e Financës dhe Shërbimit Social	Drejtoria e Financës dhe Shërbimit Social	Drejtoria e të ardhurave vendore	I lartë	I lartë
3	Drejtoria e të Ardhurave Vendore	Sektori i prokurimeve publike	Sektori i prokurimeve publike	I lartë	I lartë
4	Sektori i prokurimeve publike	Sektori i Planifikimit Urban	Drejtoria e Planifikimit Urban, projekteve, shërbimeve dhe emergjencave civile	I lartë	I lartë
	Drejtoria e Planifikimit Urban, projekteve, shërbimeve dhe	Inspektoriat i vendor i mbrojtjes së territorit	Njësia administrative Ruzhdie	I lartë	I ulët



	emergjencave civile							
6	Agjencia e Shërbimeve Publike	I lartë	Policia Bashkiake	I mesëm	Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Legjislativionit dhe Informimit publik	I mesëm		I mesëm
7	Kopshti nr.1	I mesëm	Njësia Administrative Zharrëz	I mesëm	Agjencia e shërbimeve publike	I mesëm		I lartë
8	Qendra kulturore e fëmijëve	I mesëm	Sektori i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit	I mesëm	Kopshti nr.1	I mesëm		I mesëm
9	Drejtoria e zhvillimit bujqësor, rural, pyjor, mjedisit dhe kontrollit të ushqimeve	I mesëm	Agjencia e shërbimeve publike	I mesëm	Sektori i Integritimit European	I lartë		I mesëm
9	Sektori i zyrës me një ndalesë	I mesëm	Zbatimi i rekomandimeve të auditimit të brendshëm					
10	Zbatimi i rekomandimeve të auditimit të brendshëm		Klubi shumësportësh Albpetrol	I lartë				
11			Sektori Juridik	I mesëm				



Drejtuuese e NJAB
Ernesta Mamiti

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM BASHKIA PATOS

Pasqyra 3

Plani i angazhimeve të NJAB për vitin 2024

Nr.	Subjekt e të synuara për tu audituar	Fusha për tu audituar	Auditime gjithësej	Shërbimet e sigurisë					Shërbimet e këshillimit	Grupi i auditimit
				Përputhshmërie	Performance	Financiare	Tek. Të informacionit	Të kombinuara		
1	Bashkia Patos	Drejtoria e Integritimit European, Arsimit, Kulturës dhe Sporteve	1		1					3
		Drejtoria e Financës dhe Shërbimit Social	1					1		3
		Drejtoria e të Ardhurave Vendore	1					1		3



																1	1				3
																1	1				3
																1	1				3
																1	1				3
																1	1				3
																1	1				3
																1	1				3
																1	1				3



2	Agjencia e Shërbimeve Publike	Kopshti nr.1	1	1	1	1	1	1	3	3
		Sistemi i prokurimeve	1							
		Sistemi i Pagesave							1	
		Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar								3
3	Zbatimi i rekomandimeve të auditimit të brendshëm			1						3
	Shuma		11	6	2	-	-	3		

Drejtuuese e NJAB
Ernesta Hamiti



NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM BASHKIA PATOS

Planifikim i nevojave për trajnim të NJAB për vitin 2024

Pasqyra 4

Nr.	Tematika e identifikuar për trajnim	Pjesëmarrës në trajnim	Periudha	Kohëzgjatja e trajnimit
1	Metodologjitë e auditimit	3	Janar	2
2	Auditim i fondeve të BE	3	Tetor	1
3	Auditimet e këshillimit	3	Janar	1
4	Auditim i sistemit të prokurimeve	3	Mars	3
	Shuma			7

Drejtuese e NJAB
Ernesta Hamiti



NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM BASHKIA PATOS

Planifikim i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB për vitin 2024

Pasqyra 5

Nr.	BURIMET E PLANIFIKUARA			Nr.	BUXHETI I PLANIFIKUAR	
	Shpërndarja e burimeve Njerëzore të NJAB	Ditë për tregues	Përlllogaritja e burimeve		Buxheti Gjithësej	Plani
1	Koha maksimale e vlefshme	780	52 javë x 5 ditë x 3 persona	1	Buxheti Gjithësej	2272
2	Pushime vjetore	60	4 javë x 5 ditë x 3 persona	2	Paga dhe sigurime shoqërore	2184
3	Ditë pushimi (Festa zyrtare)	42	14 ditë x 3 persona	3	Shpenzime udhëtimi dhe dieta	15
4	Pushime për arsye shëndetësore	9	3 ditë x 3 persona	4	Të tjera	70
5	Angazhime në trajnime	21	7 ditë x 3 persona	5	Numri i punonjësve	3
6	Angazhime në mbledhje/ takime	15	5 ditë x 3 persona	6	Kosto për person (1/5)	
7	Rezerva të planifikuara	15	5 ditë x 3 persona			
Totali		618	206 ditë/ personi			

Drejtuesi i NJAB
Ernesta Hamiti

